



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.921/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Kymete Kicaj, kryesuese, Ferki Xhaferi dhe Adnan Konushevc, anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Enver Kryeziu nga Subjekti Partia e Ashkalinjeve per Integrim me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Lipjanit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet pjesërisht i bazuar apeli Anr.921/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Enver Kryeziu nga Subjekti Partia e Ashkalinjeve per Integrim dega ne Lipjan per rinumërimin e vendvotimit 1314E/01D.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Lipjanit , nga radhët e subjektit politik Partia e Ashkalinjeve per Integrim ne Votimin: 1314E/01D.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në si në pikën **-II- të këtij** dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

IV. Refuzohet e pabazuar pjesa e apelit e paraqitur nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Enver Kryeziu nga Subjekti Partia e Ashkalinjeve per Integrim me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar që të detyrohet KQZ-ja, për ti rinumëruar ne teresi votat me kusht ne komunën e Lipjanit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Enver Kryeziu nga Subjekti Partia e Ashkalinjeve per

Integrim me seli në Prishtinë në të cilën pretendon se ka fakte të se votat me kusht gjithsej 4 vota ishin për mua sipas vëzhguesve tone dhe se duhej të kishte gjithsej 159 ndërsa kam vetëm 155 vota, kërkon që votat me kusht të rinumërohen edhe një herë për shkak se dallimi me kandidatin tjetër është vetëm 1 votë, si dhe të rinumërohet vendvotimi 1314E/01D për shkak të ndërhyrjeve në FRP.

Apeli është pjesërisht i bazuar.

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit Enver Kryeziu nga Subjekti Partia e Ashkalinjeve për Integrim me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Lipjanit, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve të votave me kusht, dhe në vendvotimin 1314E/01D.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit 1314E/01D të vendosur si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Formularin e Rezultateve të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara kandidati për Kuvend Komunal Enver Kryeziu, ka ndërhyrje në FRP tek votat e kandidati Perparim Kryeziu, andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëjë rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartëcituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëroi që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese si në pikën -IV-, te dispozitivit, paneli vlerësoi se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por mbeten vetëm në suaza të dyshimit sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.921/2021 më datën 07.11.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.